



Republika e Kosovës

Komuna e Rahovecit

Kabineti i Kryetarit




LISTA E VENDIMEVE TË MARRA NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT, Z. SMAJL LATIFI

MUAJI NËNTOR 2025

Nr	Emri i vendimit	Nr. Protokollit
1.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës: "Mirëmbajtja dhe servisi i automjeteve- ritenderim".	NRP-02-6691-2025
2.	Vendim për miratimin e kërkesës për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).	NRP-02-6692-2025
3.	Vendim për shfuqizimin e vendimit për pranimin në mardhënie pune të Ramadan Krasniqi nga fshati Hocë e Vogël në pozitën Drjetor në SHFMU "Heronjët e Kosovës"	NRP-02-6693-2025
4.	Vendim për caktimin e komisionit për inventarizimin e pasurive jo financiare dhe financiare.	NRP-02-6695-2025
5.	Vendim për caktimin e komisionit për regjistrimin e pasurive kapitale dhe jokapitale.	NRP-02-6696-2025
6.	Vendim për caktimin e komisionit për asgjësimin e pasurive kapitale dhe jokapitale.	NRP-02-6697-2025
7.	Vendim për përfshirjen në listën e pagës me pagë të plotë mujore.	NRP-02-6701-2025
8.	Vendim për caktimin e këshillit organizues për nder të datës 28 Nëntorit, Ditës së Falmurit Kombëtar.	NRP-02-6703-2025
9.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave "sigurimi i automjeteve të Komunës së Rahovecit.	NRP-02-6706-2025
10.	Vendim vendimin për strehim të përkohshëm emergjent.	NRP-02-6708-2025
11.	Vendim për emërimin e përkohshëm të drejtorit të ShFMU "Heronjët e Kosovës" në Hocë të Vogël.	NRP-02-6711-2025
12.	Vendim për caktimin e grupit punues për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve investive të Komunës së Rahovecit.	NRP-02-6718-2025



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të Përgjegjësit të Njesisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: **"Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve – ritenderim"**, me numër të kontratës: **623-25-8510-2-2-1/C698**, si në vijim:
 - 1.1. Samir Hasku, i sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Përgjegjës për automjetet zyrtare, në Drejtorinë për Administratë, **CAKTOHET** menaxher i kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2. Besnik Hoti, drejtor i Drejtorisë për Administratë, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës, si dhe të rregullave të tjera, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe të emërimit të Menaxherit të kontratës (MK), të gjitha përgjegjësitë, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit të Menaxherit të Kontratës.
3. Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës janë:
 - 3.1. Menaxheri i kontratës do të menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në kontratë;
 - 3.2. Menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë; dhe
 - 3.3. Menaxheri i kontratës do të bëjë vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.
4. Funksionet e Menaxherit të Projektit/Kontratës, janë:
 - 4.1. Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës, duhet të kyçet në

Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, Menaxheri i kontratës brenda afatit, duhet të krijojë Planin për Menaxhim të kontratës, duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";

- 4.2. Menaxheri i kontratës, duhet të lexojë kushtet e kontratës dhe të përgatisë Planin e Menaxhimit të kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me Operatorin Ekonomik;
 - 4.3. Të dorëzojë Planin e aprovuar të Menaxhimit të Kontratës, kërkesën (fletëporosinë) dhe Zotimin e mjeteve në Zyrë të Prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerrë urdhërblenjen;
 - 4.4. Pas pranimit të urdhërblenjes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendosë të dhënat në platformën elektronike, të ngarkojë në platformën elektronike urdhërblenjen dhe ta përcjellë përmes platformës tek OE-ja, nga e cila datë fillon numërimi i afatit kohor për liferim;
 - 4.5. Të sigurojë që Operatori Ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës, apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.6. Të sigurojë që Operatori Ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.7. Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet e tjera, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.8. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, të cilësisë, dhe të kohës aty ku është e përshtatshme;
 - 4.9. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
 - 4.10. Të sigurojë që të gjithë regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, të mbahen dhe të arkëvohen në modulën për menaxhim të kontratës, në sistem të prokurimit elektronik;
 - 4.11. Të nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim, nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.12. Të sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit dhe ta marrë miratimin;
 - 4.13. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, të mallrave dhe të shërbimeve;
 - 4.14. Të japë detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit; dhe
 - 4.15. Të dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit, ose nga ZKA-ja.
5. Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, janë:
- 5.1. Monitorimi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës; dhe
 - 5.2. Rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuara nga menaxherët e kontratave, nën mbikëqyrjen e tij.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.


Me vendim të njoftohen:

- *Menaxheri i kontratës,*
- *Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,*
- *Spektori i Prokurimit, dhe*
- *Arkivi.*


Smajl Latifi
Kryetar i Komunës
Zyrtar Kryesor Administrativ



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [redacted] nga Rahoveci me Nr. Protokolit 06-553/01-0042437/25, e dt. 03.11.2025 për ndihmë financiare prej 500.00€ (pesëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Znj. [redacted] nga Rahoveci me datë 03.11.2025 ka parashtruar kërkesë për ndihmë financiare për lehonitë (lindje) pasi që me datë 28.10.2025 ka lindur **Vajzë** në QKMF “Dr. Fahredin Hoti” në Rahovec.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijën, është e domosdoshme ndihma financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë për [redacted] si dhe ndihma për sigurimin e gjërave elementare për foshnjën.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi


Me vendim të njoftohen:

- **Znj.** [redacted], nga Rahoveci,
- **Drejtorja për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,**
- **Drejtorja për Buxhet dhe Financa, dhe**
- **Arkivi.**

Smajl Latifi
Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 73, lidhur me nenin 87 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2023"), nenit 67 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 90/2010"), Vendimit të Sektorit të Inspektoratit të Arsimit (SIA) në Prizren me Nr. ref. 10/04 Nr. Prot. 286 i datës 26.06.2025, Vendimit të Komisionit Ad Hoc për shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave në shkallë të dytë – Inspektoriati i Arsimit me Nr. ref. 10, nr. 527 i datës 02.09.2025, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. **SHFUQIZOHET** vendimi me Nr. Prot. 02/2947 i datës 07.11.2022 për pranimin në marrëdhënie të Ramadan Krasniqi nga fsh. Hoçë e Vogël në pozitën Drejtor në SHFMU "Heronjtë e Kosovës" në Hoçë të Vogël.
2. **NDËRPREHET** kontrata e punës për kohë të caktuar me Nr. Prot. 02/2954 e datës 08.11.2022 e lidhur në mes të Komunës së Rahovecit dhe Ramadan Krasniqi nga fsh. Hoçë e Vogël.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Pas pranimin të ankesës anonime me Nr. Prot. 189 e datës 06.05.2025, Sektori i Inspektoratit të Arsimit (SIA) në Prizren me datë 23.05.2025 ka realizuar inspektimin në Drejtorinë për Arsim në Komunën e Rahovecit për shqyrtimin e saj.

Pas sqyrtimit të gjithë dokumentacionit, Inspektoriati i Arsimit në Prizren në procesverbalin e hartuar ka hasur në disa të gjetura dhe njëkohësisht ka dhënë disa konstatime në lidhje me dokumentacionin e shqyrtuar dhe njëkohësisht ka dhënë edhe rekomandimet e saja për Drejtorinë për Arsim.

Provë: Procesverbali me Nr. ref. 10/04, nr. prot. 279 i datës 23.06.20252

Pas kësaj, Sektori i Inspektoratit për Arsim (SIA) në Prizren ka nxjerr vendim me të cilin ka obliguar Drejtorinë për Arsim dhe Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Rahovecit që të inicojë procedurat e shkarkimit të drejtorit të SHFMU "Heronjtë e Kosovës" në Hoçë të Vogël z. Ramadan Krasniqi.

Në arsyetimin e këtij vendimi, nga inspektimi i realizuar është hasur se, kualifikimet e z. Ramadan Krasniqi nuk janë të profilit arsimor dhe nuk përkojnë me normativet mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ Nr. 05/2021 – Normativi mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm.

*Provë: Vendimi i Sektorit të Inspektoratit të Arsimit (SIA) në Prizren
Ref: 10/04, Nr. Prot. 286 i dates 26.06.2025*

Pas kësaj, duke u bazuar në këshillën juridike, Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit ka bërë ankesë në afat ligjor në Komisionin për ankesa në Inspektoriatin e Arsimit në MASHTI – Prishtinë.

Pas pranimit të ankesës, Komisioni Ad Hoc për shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave në shkallë të dytë në kuadër të MASHTI-të ka marr vendim me të cilin është refuzuar si pa bazë ligjore ankesa e parashtruar nga U.D. i Drejtorit të Arsimit në Rahovec dhe njëkohësisht mbetet në fuqi Vendimi i Sektorit të Inspektoratit të Arsimit (SIA) në Prizren Ref: 10/04, Nr. Prot. 286 i dates 26.06.2025.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi mund të ngritet padi në Gjykatën Themelore - Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga data e pranimit të tij.

Me vendim të njoftohen:

- **Ramadan Krasniqi nga fsh. Hoçë e Vogël**
- **Drejtoria për Arsim**
- **Besa Bytyqi – Baraliu, Drejtoreshë e SIA në Prizren**
- **Arlinda Kallaba, Kryetare e Komisionit Ad Hoc në MASHTI**
- **NJMBNJ në Komunën e Rahovecit**
- **Arkivi.**

Smajl Latifi
Kryetari i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Preşednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 2, nenit 18 dhe nenit 19 të Rregullores MF-Nr.02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, nenit 5 të Rregullores së Komunës së Komunës së Rahovecit për menaxhimin e pasurisë jo financiare dhe inventari i papërdorshëm i komunës 01 Nr. 290/22 të datës 30.03.2022, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për inventarizimin e pasurive jo financiare dhe financiare

- 1. Caktohet komisioni për inventarizimin e pasurive jo financiare dhe financiare në Komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:**
 - 1.1** Tefik Krasniqi, kryesues,
 - 1.2** Admirim Durguti, anëtar,
 - 1.3** Bekim Krasniqi, anëtar,
 - 1.4** Sylejman Kadiri, anëtar,
 - 1.5** Luan Sharku, anëtar.
- 2.** Komisioni ka për detyrë që të bëjë inventarizimin e pasurive jo financiare dhe financiare të Komunës së Rahovecit duke u bazuar në Rregulloren MF-Nr.02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore dhe Rregulloren e Komunës së Komunës së Rahovecit për menaxhimin e pasurisë jo financiare dhe inventari i papërdorshëm i komunës 01 Nr. 290/22 të datës 30.03.2022.
- 3.** Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë deri me datë 31.12.2025.
- 4.** Obligohet komisioni që pas përfundimit të punëve të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.
- 5.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,**
- Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,**
- Drejtorisë për Administratë, dhe**
- Arkivit.**






Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine **Municipal Mayor**



Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6696 Nr. i faq/Br.str/No.pg 172

Data/Datum/Date 06 / 11 / 25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), dispozitave të Rregullores MF-Nr.02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për regjistrimin e pasurive jofinanciare kapitale dhe jokapitale

- Caktohet** komisioni për regjistrimin e pasurive jofinanciare kapitale dhe jokapitale, në këtë përbërje:
 - 1.1 Asllan Mazreku, kryesues,
 - 1.2 Meriton Gashi, anëtar,
 - 1.3 Sylejman Kadiri, anëtar,
 - 1.4 Admirim Durguti, anëtar,
 - 1.5 Faik Thaqi, anëtar.
- Komisioni sipas pikës 1 të këtij vendimi ka për detyrë që të bëjë regjistrimin e pasurive jofinanciare kapitale dhe jokapitale në Komunën e Rahovecit.
- Obligohet komisioni që këto punë ti kryejë duke u bazuar në Rregulloren MF-Nr.02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore dhe legjislacionin aktual në fuqi.
- Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë deri më datë 31.12.2025.
- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi

Kryetari i Komunës






Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/ Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Prešednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), dispozitave të Rregullores MF-Nr.02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për asgjësimin e pasurive Kapitale dhe jokapitale

1. **Caktohet** komisioni për inventarizimin e pasurive jo financiare dhe financiare në Komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:
 - 1.1 Luan Sharku, kryesues,
 - 1.2 Samir Hasku, anëtar,
 - 1.3 Tefik Krasniqi, anëtar,
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë asgjësimin e pasurive Kapitale dhe jokapitale në Komunën e Rahovecit do të jetë organ i përkohshëm i formuar nga Kryetari i Komunës.
3. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë deri me datë 31.12.2025.
4. Obligohet komisioni që pas përfundimit të punëve të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,
- Drejtorisë për Administratë, dhe
- Arkivit.



Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECI / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 6701 Nr. i faq./Br.str./No.pg 173
Data/Datum/Date 07/11/25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, si dhe nenit 92 të Statutit të Komunës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **OBLIGOHET** Drejtoria për Buxhet dhe Financa që znj. **Antigona Krasniqi**, e sistemuar në punët dhe në detyrat e punës: Zyrtar për Arsim Parafillor, në Drejtorinë për Arsim, në Komunën e Rahovecit, të përfshihet në listat e pagave me pagë të plotë mujore, duke filluar nga data 7.11.2025.
2. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimit u dorëzohet:

1. Antigona Krasniqi,
2. Drejtorisë për Financa dhe Buxhet,
3. Njesisë së Personelit, dhe
4. Arkivit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E RAHOVECI
KRYETARI I KOMUNËS
Smajl Latifi
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KRYETARIJT E KOMUNES / KABINETI PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6703 Nr. i faq./Br.str./No.pg 173

Data/Datum/Date 11 / 11 / 25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e këshillit organizues për nder të 28 Nëntorit, Ditës së Flamurit Kombëtar

1. **Caktohet** këshilli organizues për nder të 28 Nëntorit, Ditës së Flamurit Kombëtar, në këtë përbërje:
 - 1.1. Fatmir Iska, kryesues,
 - 1.2. Afrim Limani, anëtar,
 - 1.3. Afrim Dina, anëtar
 - 1.4. Dervish Çadraku, anëtar,
 - 1.5. Feriz Thaqi, anëtar,
 - 1.6. Saranda Sallteku, anëtare,
 - 1.7. Besmire Bytyçi, anëtare,
 - 1.8. Ardit Halilaj, anëtar,
 - 1.9. Shedat Ukaj, anëtar,
 - 1.10. Mentor Veliu, anëtar,
 - 1.11. Muharem Morina, anëtar,
 - 1.12. Blerta Nalli-Gashi, anëtare,
 - 1.13. Naser Dula, anëtar,
 - 1.14. Isuf Gashi, anëtar.
2. Këshilli organizues ka për detyrë të ndërmarrë të gjitha veprimet organizative për shënimin e 28 Nëntorit, Ditës së Flamurit Kombëtar.
3. Obligohet këshilli që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Këshilli organizues është i obliguar që t'i raportojë kryetarit të Komunës mbi ecurinë dhe mbarëvajtjen dhe shpenzimet e organizimit.
5. Këshilli do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat të arsyeshëm.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e këshillit organizues dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
7. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Anëtarët e këshillit organizues,
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe
- Arkivi.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNES / KABINET-PRESEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6706 Nr. i faq./Br.str./No.pg 173

Data/Datum/Date 11 / 11 / 25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: “**Sigurimi i automjeteve të Komunës së Rahovecit**”, me nr. prokurimi: **623-25-9589-2-2-1** dhe me nr. të brendshëm: **623-25-048-2-2-1**, të datës 11.11. 2025, në këtë përbërje:
 - 1.1. Egzon Thaqi, kryesues,
 - 1.2. Vjollca Berisha, anëtare,
 - 1.3. Veton Kabashi, anëtar.
2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin: “Sigurimi i automjeteve të Komunës së Rahovecit”, me nr. prokurimi: 623-25-9589-2-2-1 dhe me nr. të brendshëm: 623-25-048-2-2-1, të datës 11.11.2025.
3. Obligohet komisioni që këto punë t’i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të komisionit,*
- *Zyrës së Prokurimit, dhe*
- *Arkivit.*

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6768 Nr. i faq./Br.str/No.pg 173

Data/Datum/Date 12 / 11 / 25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13, nenit 17 pika k) dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008"), nenit 12 pika 12.1, 12.4 dhe 12.5 të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.11, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, dhe kërkesës së Ganimete Elshani me Nr.Prot. 3666 të datës 28.10.2025, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. **Miratohet** kërkesa e znj. [REDACTED] nga Rahoveci për strehim të përkohshëm emergjent si rast në nevojë sociale në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, respektivisht prej datës 3.11.2025 deri me datë 3.5.2026, tek familja strehuese [REDACTED] nga Rahoveci. Pagesa në emër të qirasë mujore do të jetë në shumën prej 150.00€ (njëqind e pesëdhjetë euro) për çdo muaj.
2. **Autorizohet** Drejtoresha e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Komunën e Rahovecit që të lidh marrëveshje për strehim të përkohshëm të familjes në nevojë.
3. Përfitues sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi është znj. [REDACTED] së bashku me fëmijët: [REDACTED]
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Komunën e Rahovecit ka pranuar kërkesë nga znj. [REDACTED] për ndihmë për strehim pasi që nuk ka shtëpi ku të jetojë pasi që nga të ardhurat e ndihmës sociale nuk mund të ndërtojë shtëpi.

DSHPS ka dalur në vendin e ngjarjes dhe ka vizituar familjen në nevojë me ç'rast ka konstatuar se kjo familje është duke jetuar përkohësisht në një shtëpi me qira dhe në kushte të vështira ekonomike.

Andaj, duke marrë parasysh nevojën për ndihmë të familjes në nevojë të znj. [REDACTED] e cila është duke jetuar në kushte të vështira ekonomike, dhe se e njëjta e ka të pamundur mbulimin e shpenzimeve për jetesë dhe pagesën e qirasë, është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje.

Andaj, nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Z. [REDACTED]
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6711 Nr. i faq./Br.str./No.pg 174

Data/Datum/Date 14 / 11 / 2025

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), neni 38 i Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 17/2011"), neni 18 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesionalë, Asistentëve, Instrukturëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, neni 74 dhe neni 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e përkohshëm të drejtorit të ShFMU "Heronjtë e Kosovës" në Hoçë të Vogël

1. Driton Krasniqi nga fshati Hoçë e Vogël, komuna e Rahovecit, **EMËROHET** përkohësisht drejtor në ShFMU "Heronjtë e Kosovës" në Hoçë të Vogël.
2. I lartpërmenduri sipas pikës 1 të këtij vendimi emërohet përkohësisht drejtor në ShFMU "Heronjtë e Kosovës" në Hoçë të Vogël nga data 14.11.2025 deri në përfundimin e procedurave të konkursit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës së këtij institucioni arsimor.
3. Të lartpërmendurit në pikën 1 të këtij vendimi i takon kompensimi i pagës së drejtorit/eshës së ShFMU-së deri në përfundim të emërimit të përkohshëm.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit.

A r s y e t i m

Duke marrë parasysh se është shkëputur kontrata e punës e drejtorit të ShFMU "Heronjtë e Kosovës" në Hoçë të Vogël, Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit, ka parashtruar kërkesë për emërimin e përkohshëm të drejtorit në ShFMU "Heronjtë e Kosovës" në Hoçë të Vogël.

Pas shqyrtimit të kërkesës së Drejtorisë për Arsim, duke u bazuar në nenin 18 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesionalë, Asistentëve, Instrukturëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, Driton Krasniqi nga fshati Hoçë e Vogël, emërohet përkohësisht drejtor në ShFMU "Heronjtë e Kosovës" në Hoçë të Vogël.

I lartpërmenduri emërohet përkohësisht drejtor në ShFMU “Heronjtë e Kosovës” në Hoçë të Vogël nga data 14.11.2025 deri në përfundimin e procedurave të konkursit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës së këtij institucioni arsimor.

Këshilla juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të vendimit, Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesa në kuadër të Komunës së Rahovecit.

Me vendim të njoftohen:

- *Driton Krasniqi nga fshati Hoçë e Vogël,*
- *Drejtoria për Arsim,*
- *NJMBNJ-ja, dhe*
- *Arkivi.*

